



# SBASHK

## Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

# Arsimimi

### KULTURA E NJERIUT

*Ë-buletin*



*Tetor, 2016*

SBASHK-u edhe një takim me Ministrin Bajrami dhe Kabinetin e tij  
**U diskutua për shumë çështje të rëndësishme**



Në përpjekje për të gjetur zgjidhje për të gjitha çështjet e ngritura në arsimin e Kosovës, delegacioni i SBASHK-ut i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë zhvilluar edhe një takim të rëndësishëm me Ministrin e MASHT-it, Prof. Dr. Arsim Bajrami dhe Kabinetin e tij. Të dy palët kanë bashkëbiseduar për të gjitha (faqe 4)

SBASHK-u në takime me shefat e Grupeve Parlamentare

**Premtime për mbështetje në angazhimet e SBASHK-ut**



*Pasi më parë janë takuar me shefat e Grupeve Parlamentare të PDK-së e LDK-së, delegacioni i SBASHK-ut i përbërë nga ... (faqe 4)*

Forcohet bashkëpunimi i sindikatave tjera me SBASHK-un

**SBASHK-u gëzon respekt për angazhime konkrete sindikale**

Duke çmuar angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut në shërbim të arsimit dhe anëtarësisë së vet, janë shumë ... (faqe 7)

*Intervistë me kryetaren e Kuvendit të SAF e SAM të Obiliqit, znj. Luljeta Boshnjaku*

**Do të forcohet roli i femrës në SBASHK**

Luljeta është mësimdhënëse e dalluar në një vatër të njohur arsimore në Kastriot (Obiliq). Respekti që gëzon kudo ka bërë që ajo të zgjidhet... (faqe 3)

Këshilli Drejtues i SBASHK-ut ka alarmuar me kohë

**Nëse nuk ka dialog do të ketë veprime sindikale**



Këshilli Drejtues i SBASHK-ut ka mbajtur më 22 tetor takimin e radhës dhe pas analizës së bërë ka alarmuar institucionet lokale e qendrore ... (faqe 6)



## Editorial

### Vitet e 90-ta pjesë e veçantë e historisë së arsimit tonë



Atyre që ishin mësimdhënës kudo në Kosovë në vitet shkollore 1989/90 e deri në vitin shkollor

1998/99 ju kujtohen gjithë ato sakrifica që janë bërë në mbrojtje të arsimit e kulturës sonë nga sulmet e vazhdueshme të pushtuesit. Ditët, muajt dhe vitet atëherë shënoheshin me ngjarje plot ankth. Kudo raporte për rrahje, maltretime e sulme të vazhdueshme. Shkolla shqipe e asaj kohe ka edhe dëshmorët e vetë. Mësimdhënësit punonin dhe nuk ndaleshin sepse po mbanin në zemër alfabetin shqip dhe po ruanin që të mos shuhej fjala shqipe në këto troje dhe vullneti për të pasur edhe ne liri dhe shtet.

Mësimdhënësit e atyre viteve marshonin guximshëm bashkë me nxënësit drejt diturive të reja dhe populli iu jepte guxim me fjalë të mira e me respekt të lartë.

Liria erdhi falë angazhimit sublim me pendë e pushkë të njerëzve të këtij nënqielli. Njerëzit e zgjedhur nga vota e popullit në takime publike me zë të lartë flisnin për vitet e 90-ta dhe ngritnin në qiell punën e madhe dhe misionin atdhetar e njerëzor të mësuesit. Por, pak kanë bërë që konkretizon të njihet gjithë ajo sakrificë dhe të ruhet e mbrohet me ligj ajo periudhë e veçantë e arsimit shqip dhe e Kosovës në tërësi.

SBASHK-u bëri gjithë këto angazhime dhe u takua me sa e sa udhëheqës të institucioneve e të subjekteve politike për të gjetur bashkë me ta një zgjidhje të mirë për Ligjin mbi statusin e mësimdhënësve të asaj kohe, por ata që dikur kishin folur zëshëm e me plot zjarr për ato vite, tani janë në pushtet , por u është zbehur disi zëri. Respekti për atë kohë dhe për njerëzit e saj obligon të gjithë për angazhime.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)**  
përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervistë me kryetaren e Kuvendit të SAF e SAM të Obiliqit, znj. Luljeta Boshnjaku

### Do të forcohet roli i femrës në SBASHK



Luljeta është mësimitdhënëse e dalluar në një vatër të njohur arsimore në Kastriot (Obiliq). Respekti që gëzon kudo ka bërë që ajo të zgjidhet kryetare e Kuvendit të SAF e SAM në këtë komunë. “Roli i femrës është

shumë i rëndësishëm në angazhimin sindikal duke pas parasysh se në sistemin arsimor, një përqindje të mirë e përbën gjinia femërore”, shprehet në intervistën për gazetën tonë, znj. Luljeta.

*Arsimimi Sot:*

#### 1. Kush është Luljeta Boshnjaku?

Luljeta:

Jam arsimtare në SHFMU “ Dr Ibrahim Rugova” nga viti 1995. Studimet i kam përfunduar në Fakultetin Filozofik-dega Histori. Si anëtare e shoqatës sindikale nga viti 2003 kisha edhe postin e nënkryetarit të shoqatës sindikale.

*Arsimimi Sot:*

#### 2. Tani jeni zgjedhur kryetare e nivelit komunal në sindikatë. Si e çmoni këtë?

Luljeta:

Zgjedhja në postin e kryetares së degës sindikale në nivelin komunal do të thotë shumë. Fillimisht kam fituar besimin e punonjësve, por njëkohësisht kam edhe privilegjin t’i përfaqësoj ata, sidomos kolegët e shkollës në të cilën punoj, si dhe kryetarët e shoqatave sindikale në kuadër të Komunës së Obiliqit. Po kështu ndjej se jam e privilegjuar që kam nderin t’i bashkëngjitem SBASHK-ut për t’u angazhuar për të drejtat e punëtorëve arsimor.

*Arsimimi Sot:*

#### 3. Sa është e përfaqësuar femra në procesin edukativo-arsimor në komunën tuaj?

Luljeta:

Fatmirësisht përfaqësimi i femrës në komunën tonë është i kënaqshëm, për faktin se kemi femra në vendet udhëheqëse në kuadër të shkollave, por dhe në

drejtoritë komunale. Kjo nuk do të thotë se nuk duhet të synojmë për rritje të mëtejme të përfaqësimit të saj.

*Arsimimi Sot:*

#### 4. Cili është roli i femrës dhe të rinjve në angazhimin sindikal në komunën tuaj?

Luljeta:

Roli i femrës është shumë i rëndësishëm në angazhimin sindikal duke pas parasysh se në sistemin arsimor, një përqindje të mirë e përbën gjinia femërore. Shpresoj se zgjedhja ime do të jetë një shtytje edhe më e madhe për angazhimin shtesë të femrave dhe rinisë.

*Arsimimi Sot:*

#### 5. Çfarë do të veçonit për të mirë në SBASHK?

Luljeta:

Insistimi i vazhdueshëm për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, me çka edhe u arrit zbatimi i Kontratës Kolektive, përkrahja e kërkesave që të shpaguhet munda i punëtorëve arsimor në vitet e nëntëdhjeta ,dhënia e tri pagave punëtorëve të cilët kanë dalë në pension.

*Arsimimi Sot:*

#### 6. Çfarë i propozoni SBASHK-ut të bëjë më shumë në shërbim të anëtarësisë?

Luljeta:

Të qëndroj në vendosmërinë për realizimin e kërkesave të punëtorëve arsimor, krijimi i kushteve më të mira për një arsimim efektiv.

*Arsimimi Sot:*

#### 7. A keni diçka për të shtuar?

Luljeta:

Duke e pas parasysh qasjen ndaj problemeve të punëtorëve arsimor dhe përpjekjet e vazhdueshme të SBASHK-ut në realizimin e kërkesave të punëtorëve arsimor shpresoj se edhe ai numër i vogël i punëtorëve arsimor që nuk janë bashkëngjitur shoqatave sindikale t’i bashkëngjiten sepse së bashku do të realizojmë të drejtat tona-BASHKIMI BËN FUQINË.

## Gjatë muajit

SBASHK-u edhe një takim me Ministrin Bajrami dhe Kabinetin e tij

### U diskutua për shumë çështje të rëndësishme

Në përpjekje për të gjetur zgjidhje për të gjitha çështjet e ngritura në arsimin e Kosovës, delegacioni i SBASHK-ut i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë zhvilluar edhe një takim të rëndësishëm me Ministrin e MASHT-it, Prof. Dr. Arsim Bajrami dhe Kabinetin e tij.

Të dy palët kanë bashkëbiseduar për të gjitha çështjet aktuale në arsim dhe janë shprehur se me angazhime të përbashkëta do të mundohen që të gjejnë zgjidhje pozitive për çështjet e ngritura e që lidhen me Kontratën Kolektive dhe me Ligjin për Statusin e Punëtorëve të Arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 1990/91 e deri në vitin shkollor 1998/99.

Ministri Bajrami ka kujtuar se MASHT-i ka dorëzuar në qeveri Projektligjin dhe se ai ka bërë shumë angazhime që ky projektligj të procedohet në Parlament. Ministri Bajrami ka shprehur gatishmërinë për angazhime në mënyrë që bashkë me delegacionin e SBASHK-ut të kenë takime me kreun e Qeverisë dhe bashkërisht të gjejnë zgjidhje për gjithë kërkesat e të punësuarve në arsim. Të dy plot kanë biseduar edhe lidhur me nevojën që të ketë takime të komisioneve të




SBASHK-ut e MASHT-it për tekstin e Kontratës Kolektive në mënyrë që të krijohen parakushtet dhe përmes dialogut të arrihet të pajtueshmëria për versionin final të Kontratës, e cila pastaj do të nënshkruhej nga MASHT-i dhe SBASHK-u.

SBASHK-u në takime me shefat e Grupeve Parlamentare

### Premtime për mbështetje në angazhimet e SBASHK-ut

Pasi më parë janë takuar me shefat e Grupeve Parlamentare të PDK-së e LDK-së, delegacioni i SBASHK-ut i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë vazhduar me agjendën e takimeve me shefat e Grupeve Parlamentare të subjekteve politike në Parlamentin e Kosovës. Ata në përpjekje për të gjetur përkrahjen e deputetëve të Parlamentit kanë pasur takime të ndara me z.Zenun Pajaziti, z. Pal



Lekaj, z. Glauk Konjufca dhe me znj. Valdete Bajrami.

Në takim me shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së, z. Pajaziti, delegacioni i SBASHK-ut ka shpalosur shqetësimet anëtarësisë e veçmas lidhur me fatin e ligjit për statusin e mësimdhënësve shqiptar të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta.

Shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, z. Pajaziti është shprehur i gatshëm që bashkë me deputetet e subjektit të tij politik të angazhohen në mbështetje të kërkesave të SBASHK-ut.

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës


Në takimin me shefin e Grupit Parlamentar të AAK-së, z. Pal Lekaj delegacioni i SBASHK-ut ka treguar për angazhimet që janë duke u bërë me qëllim që përmes dialogut të gjendet zgjidhje e merituar lidhur me Ligjin për statusin e mësimit të viteve të 90-ta. Lekaj bashkë me deputetin e këtij subjekti politik, z. Rustem Berisha janë shprehur se kanë respekt për angazhimet e SBASHK-ut dhe se çmojnë lartë përkushtimin dhe sakrificat e mësimit të viteve të 90-ta dhe se do të angazhohen në përkrahje të realizimit të kërkesës lidhur me Ligjin për statusin



e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet shkollore 1989/99.

Po në ambientet e Parlamentit të Kosovës ky delegacion i SBASHK-ut ka zhvilluar takimin e shefine Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, z. Glauk Konjufca. Ishte kjo edhe një përprjekje për të gjetur mbështetjen e deputetëve lidhur me Ligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet shkollore 1989/99. Shefi i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, z. Glauk Konjufca i ka dhënë mbështetje këtij angazhimi të SBASHK-ut duke deklaruar se ai dhe Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes do të angazhohen brenda mundësive që të krijohen mundësi që Ligji të shkojë në Parlament dhe të votohet nga deputetët e Kuvendit.

Edhe takimi me shefen e Grupit parlamentar të Nisma për Kosovën, znj. Valdete Bajrami ishte mjaft përmbajtjesor.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut, kryetari Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri e kanë njoftuar shefen znj. Bajrami lidhur me situatën aktuale në arsim duke i treguar se janë tensionet nëpër shkolla për arsye se Qeveria tani e sa kohë nuk po e procedon Projektligjin për vitet e 90-ta në Parlament. Përfaqësuesit e SBASHK-ut i kanë dorëzuar znj. Bajrami një kopje të Projektligjit që gjendet në Qeveri dhe Rekomandimet që Parlamenti i Kosovës në seancat e 11 e 18 prillit 2013 ka nxjerrë lidhur me këtë çështje.

Kryetarja e Grupit parlamentar të Nisma ka thënë se SBASHK-u gëzon përkrahjen e plotë për angazhimet



në realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Ajo po ashtu ka shprehur respekt të lartë për gjithë mësimit të viteve të 90-ta dhe për qëndresën dhe punën e tyre të përkushtuara në shërbim të ruajtjes së arsimit dhe shpresës për liri. Ajo pastaj ka deklaruar se ajo bashkë me deputetët e subjektit politik që përfaqëson do të debatojnë për këtë kërkesë legjitime të SBASHK-ut dhe do të angazhohen për realizimin e kësaj kërkesë.

## Këshilli Drejtues i SBASHK-ut ka alarmuar me kohë Nëse nuk ka dialog do të ketë veprime sindikale

Këshilli Drejtues i SBASHK-ut ka mbajtur më 22 tetor takim të radhës dhe pas analizës së bërë ka alarmuar institucionet lokale e qendrore të shtetit se nëse nuk ka dialog do të ketë veprime sindikale në gjithë institucionet e arsimit të Kosovës.



Anëtarët e këshillit Drejtues janë njoftuar fillimisht me përmbajtjen e përgjigjes me shkrim të Ministrit Arsim Bajrami në letrën e SBASHK-t lidhur me kërkesat e anëtarësisë dhe pastaj ata kanë marrë nga një kopje të kësaj shkresë për ta pasur si mbështetje në angazhimet nëpër komuna në takimet me qeveritë lokale e lidhur me kërkesat që ato qeveri janë të obliguara t'i realizojnë.

Çështje që ka zgjuar debat në këtë takim ishte ajo e fatit të Ligjit për Statusin e Punëtorëve të Arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 1990/91 e deri në vitin shkollor 1998/99. Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, kanë treguar për gjithë ato përpjekje e takime me Ministra, shefa të Grupeve Parlamentare e deputetë me qëllim që të krijohet hapësirë për dialog lidhur me këtë çështje shumë të rëndësishme.

Po ashtu në kuadër të diskutimeve është folur edhe për sfidat në UP. Është veçuar kërkesa legjitime për unifikimin e pjesës stimuluese me pagën bazë për të punësuarit në administratën e UP-së, kërkesë kjo që nuk po realizohet ende. Pas diskutimeve Këshilli Drejtues ka vendosur që të pritët deri më 9 nëntor që



këto dy çështje dhe çështjet që dalin nga Kontrata Kolektive të zgjidhen me dialog, në të kundërtën më 10 nëntor në takim të jashtëzakonshëm Këshilli Drejtues do të vendos për veprime sindikale.

Këshilli Drejtues po në këtë takim është njoftuar përmes një raporti të gjerë lidhur me vizitën studimore të një delegacioni të SBASHK-ut në Gjermani, vizitë kjo e mundësuar nga GIZ. Po ashtu është raportuar edhe lidhur me organizimin dhe rrjedhën e Konferencës kushtuar 5 tetorit – Ditës Botërore të Mësuesit dhe për përgatitjet lidhur me përgatitjen e versionit të ri të tekstit të Kontratës Kolektive të



Arsimit, pasi Kontrata ekzistuese vlen deri në prillin e vitit 2017.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka paraqitur edhe një vlerësim të angazhimeve të kryetarëve të niveleve komunale dhe ka thënë se në bazë duhet shtuara aktivitetin duke vizituar shkollat e duke bashkëbiseduar me anëtarësinë për gjithë çështjet aktuale.

Forcohet bashkëpunimi i sindikatave tjera me SBASHK-un

## SBASHK-u gëzon respekt për angazhime konkrete sindikale

Duke çmuar angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut në shërbim të arsimit dhe anëtarësisë së vet, janë shumë Federata sindikale në Kosovë që duan ta forcojnë bashkëpunimin me SBASHK-ut. Pas një memorandumi me sindikatën e policisë e shëndetësisë, sot është hedhur një hap i mirë drejtë një memorandumi bashkëpunimi edhe me Sindikatën e Punëtorëve të Postës së Kosovës. Kryetari i kësaj sindikate, Etrit Hoti bashkë me Etibon Fetaj, zyrtar për marrëdhënie me jashtë dhe me institucionet kanë qëndruar në selinë e SBASHK-ut dhe kanë zhvilluar një bashkëbisedë të sinqertë duke



shikuar mundësitë e bashkëpunimit. Ata janë pritur nga kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, nënkryetari Lutfi Mani dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri. SBASHK-u është shprehur se ka gatishmërinë e vazhdueshme për bashkëpunim të sinqertë me federatat tjera në shërbim të krijimit të një zëri sa më të fuqishëm sindikal dhe se ka gatishmërinë e plotë për të nënshkruar një memorandum bashkëpunimi edhe me Sindikatën e Punëtorëve të Postës së Kosovës.

Delegacioni i SBASHK-ut në Kongresin V të Sindikatës së Arsimit të Malit të Zi

## Takime me kolegët sindikalistë nga Ballkani dhe Evropa

Sindikata e Arsimit e Malit të Zi (SPCG) me datën 29 tetor 2016 ka mbajtur Kongresin V në të cilin kanë debatuar për çështjet aktuale duke caktuar edhe planin e angazhimeve për 5 vitet e ardhshme. Delegatët e këtij Kongresi kanë debatuar për sfidat e arsimit dhe mundësitë e përmirësimit të pozitës së mësimdhënësve, të cilat çështje i paraqiti edhe Kryetari Zvonko Paviqeviç.



Kongresi rizgjidi z. Zvonko Paviqeviç për kryetar të kësaj sindikate në mandatin e ardhshëm 5 vjeçar. Në punimet e këtij Kongresi kanë marrë pjesë përfaqësues nga Qeveria e Malit të Zi dhe delegacione sindikale nga nëntë shtete si dhe

Nënkryetari i Sindikatës Evropiane të Arsimit (ETUCE) Branimir Strukelj.

Sindikata e Arsimit të Malit të Zi (SPCG) kishte nisur me aktivitetet para Kongresit, të cilat ua kishin dedikuar mysafirëve nga shtetet e Ballkanit dhe Evropës duke organizuar vizita në Monumentet në Podgoricë dhe rrethinë në shenjë mikpritjeje.

Delegacioni i SBASHK-ut ishte i përbërë nga nënkryetari z. Lutfi Mani dhe menaxheri për financa e këshilltari për organizim të brendshëm, z. Ymer Ymeri. Në fjalën përshëndetëse të nënkryetarit Mani tregoj për bashkëpunimin e mirë që kanë sindikatat tona dhe gatishmërinë e vazhdimtë të këtij bashkëpunimi dhe ju dëshiroj punë të suksesshme Kongresit të V.

Delegacioni i SBASHK-ut krahas pjesëmarrjes në Kongres , gjatë qëndrimit në Podgoricë ka zhvilluar takime të shumta me përfaqësues të sindikatave nga shtetet e Ballkanit dhe Evropës. Me përfaqësues të sindikatës së Arsimit të Malit të Zi është biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit për çka janë pajtuar të dy palët. Një takim i veçantë ka qenë ai me delegacionin nga Sindikata sllovene e arsimit, shkencës dhe Kulturës ( SVIZ ), që po kryesohej nga sekretari gjeneral dhe mik i vjetër i SBASHK-ut, z. Branimir Strukelj, i cili është edhe nënkryetar i Sindikatës Evropiane të Arsimit (ETUCE) . Në këtë takim është bashkëbiseduar për gjendjen në arsimin e të dy vendeve, por edhe në përgjithësi në Ballkan, Evropë



dhe botë dhe është përsëritur nevoja që duke qenë në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit në përgjithësi duhet vazhduar me bashkëpunimin dhe solidaritetin sindikal.

Delegacioni slloven është interesuar për aktivitetet e SBASHK-ut dhe për angazhimet në të ardhmen duke shprehur edhe një herë gatishmërinë për përkrahje dhe bashkëpunim miqësor mes të dy sindikatave.

Delegacioni i SBASHK-ut ka shprehur interesimin se si Sindikata e Arsimit Slloven e ka të nënshkruar Kontratën Kolektive për Arsimin Universitar ,për çka Kryetarja e SVIZ-it, Jelka Veliqi dhe Sekretari i Përgjithshëm Branimir Strukelj kanë marrë informacionin se Kontrata Kolektive në Slloveni nënshkruhet me Ministrinë e Arsimit për të gjitha nivelet arsimore bashkërisht.

## U mbajt Kuvendi zgjedhor i SAF e SAM në Kastriot ( Obiliq) **Me votat e Kuvendit kryetare u zgjodh Luljeta Boshnjaku**

Kryetarët e shoqatave sindikale të shkollave fillore e të mesme të komunës së Kastriotit ( Obiliqit) kanë mbajtur Kuvendin zgjedhor dhe me vota të fshehta



kanë zgjedhur kryetare të këtij kuvendi znj. Luljeta Boshnjaku. Zgjedhja e znj. Luljeta në krye të sindikalistëve të Kastriotit është një fakt që tregon se në SBASHK po fuqizohet roli i femrës.

Takimin e ka hapur kryetari i deri tashëm , z. Kadri Thaçi, i cili fillimisht ka përshëndetur kryetarin Rrahman Jasharaj dhe Ymer Ymerin e Blendor Shatrin, që po përfaqësonin SBASHK-un në këtë takim. Ai pastaj ka paraqitur raportin e punës për katër

vite të aktiviteteve, që është aprovuar dhe është lavdëruar nga anëtarët e këtij Kuvendi.

Pra se të kalohej në zgjedhjet e reja në këtë Kuvend, është zhvilluar një bashkëbisedë mes kryetarëve të shoqatave sindikale dhe përfaqësuesve të SBASHK-ut.

Pas kësaj z. Kadri Thaçi ka informuar Kuvendin me propozimet konkrete nga shoqatat sindikale për kryetar të ri të Kuvendit. Pra, kryetare është zgjedhur znj. Luljeta Boshnjaku, kurse nënkryetar përfaqësuesi nga shkollat mesme z. Imer Hamiti. Kuvendi ka vendosur që një post udhëheqës të jetë për përfaqësuesit e çerdheve.

Kuvendi i SAF e SAM i kësaj komune ka çmuar lartë angazhimin sindikal të z. Kadri Thaçi dhe në shenjë respekt për angazhimet e tij e kanë zgjedhur kryetar nderi.